

Njoftime mbi Kartën e Kaltër/Blu

Çfarë është Karta e Kaltër/Blu?

Karta e Kaltër është hartuar nga qyteti Thun. Kjo i jep të drejtën për rimbursim prej 50% të shpenzimeve, aktiviteteve të mëposhtme:

- kampet e pushimit dhe kampet e skive të organizuara nga shkollat fillore .
- javët e ekskursionit me shkollën, javët e projektit, javët e studimit.
- udhëtimet me shkollën, udhëtimet edukative.
- ofertat vullnetare për pushime nga qyteti Thun (*Ferienpass*).
- Ishulli i pushimeve në Thun.
- aktivitete të tjera të lidhura me shkollën me një synim të ngjashëm.
- Për prindërit: 50.-- CHF mbulim shpenzimesh pas ndjekjes të një kursi të gjuhës gjermane.

Mbajtësit e Kartës së Kaltër kanë të drejtë gjithashtu, të ndjekin kurse falas në kuadër të sporteve shkollore të organizuara vullnetarisht në qytetin Thun.

Kush ka të drejtë të kërkojë një Kartë të Kaltër/Blu?

Kartën e Kaltër në qytetin Thun e marrin fëmijët e moshës shkollore prej kopshtit të fëmijëve deri në klasën e 9-të / përfundimin e shkollimit të detyrueshëm. Për t'u aprovuar dhënia e një Karte të Kaltër, duhen paraqitur detyrimisht të ardhurat neto në përputhje me pagesën përfundimtare të periudhës së fundit tatimore. Karta e Kaltër jepet vetëm nëse të ardhurat neto të personave që jetojnë në të njëjtën familje nuk e kalojnë një shifër të caktuar.

Familje me	Të ardhura neto deri në CHF
2 persona	35'700.00
3 persona	44'900.00
4 persona	52'700.00
5 persona	58'100.00
6 persona	63'500.00
7 ose më shumë persona	66'500.00

Si mund të bëhet një kërkesë për Kartën e Kaltër/Blu?

Formularët e aplikimit mund të kërkojnë tek Zyra e Arsimit dhe Sporteve.

- Miratimi i Kartës së Kaltër është për një vit shkollor. Pas një viti, prindi ose kujdestari dërgon një kërkesë për rishikim të autorizimit të Kartës së Kaltër nëpërmjet Zyrës së Arsimit dhe Sporteve.
- Prindërit apo Kujdestarët përgjegjës, të cilët mbështeten nga shërbimet sociale apo zyra e koordinimit për azilantin, kanë të drejtën për një Kartë të Kaltër (lutemi shënoni me kryq kutinë e duhur në Kartën e Kaltër.)
- Të ardhurat neto, që rezultojnë prej tatimit të paguar që në burim, nuk njihen nga administrata tatimore. Prandaj, prindi ose kujdestari duhet të deklarojë të ardhurat neto nëpërmjet një formulari (që merret në Zyrën e Arsimit dhe Sporteve). Llogaritja e të ardhurave neto bëhet nga zbritja e disa shpenzimeve me përafërsi (*Pauschal*), prej të ardhurave tuaja.

Si procedohet për pagimin e rimbursimit?

- Kërkesat për pagesën janë të vlefshme, **jo më vonë se brenda gjashtë muajve që nga data e zhvillimit të aktivitetit.**
- Kontributet sipas rregullores paguhen vetëm **pas kryerjes së aktiviteteve** respektive dhe pas dorëzimit të një **fature përfundimtare me nënshkrimin e mësuesit.**
- Dokumentet përkatëse duhet të dorëzohen me formularin "Rimbursim i Kartës së Kaltër/Blu - *Rückerstattung Blaue Karte*" në Zyrën e Arsimit dhe Sporteve.